

politik, shoqnor e ekonomik; të shkrimun shpirtnash në një dishiplinë kombtare të rreptë, një drejtim organik i mprojtës së drejtes së gjitha interesave, ka me siguri mirëvajtjen shpirtnore e landore të popullit Shqiptarë t'Onë të dashtun.

Zotni Këshilltarë,

Një shpirt i ri depertoj tash një vjetë jetën shqiptare përmjet veprës gjallni plotë të Qeveris e të Partis Fashiste; gjithë kah e gjithkund zgjoj energitë e racës drejtue kah kryemja e veprës së madhe të nisun mbrenda kufijve t'Atdhut, të mprojtun në mënyrë të sigurtë nga fuqit e armatosuna italiane e shqiptare, të fuqizuese në mënyrë të pershtateshme.

Kta kufij njëherë e mirë të sigurueme në të gjitha drejtimet e mbrenda, tyne populli shqiptar gjenë at qetsi e at veprimtari që përbajnë themelet e denja të jetës së tji kombëtare e të naltësimit tji.

Qysh prej këtij çasti, që ka randësi e kuptim të madh, ju merrni pjesë me detyrën e naltë t'uejën si ligjebasë në rindërtimin e vendit.

Vepra e juë, e urtë dhe e sigurtë n'ekuilibrim e pertrimun të gjitha energjinave, me vetë dijen e riringjallun të detyravet, në dishiplinen e fortë të një jete të qytetnueme dhe vepruese, ka me shpejtue arrijtjen e fatevet të reja e të nalta t'Atdhut.